



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Me të cilin vërtetoj se nga Zyra e Komisionit të Pavarur për Media KPM pranuar shkresën:

With this I confirm receipt the official document from the Office of Independent Media Commission:

Emri dhe numri i referencës:

Name and reference number:

Ime i broj referencije

z. Avni Dehari dhe znj. Xhemile Dehari

z. Tomë Gashi- avokat, përfaqësues ligjor i Palës Ankuese

Tema: Vendim lidhur me ankesën e familjes Dehari

data 10.01.2017

date:

datum:

Prishtinë

Ref: 1612/1355/KPM/am



ESAD KASHI

[Signature]

Emri i përfaqësuesit të KPM

Nënshkrimi i përfaqësuesit të KPM

Name of IMC representative

Signature of IMC representative

[Signature]

[Signature]

Emri i pranuesit dhe data
Name of Recipient and date


Nënshkrimi i pranuesit data dhe ora
Signature of Recipient date and time

Vendi/Place

Data dhe ora /Date and time:

PRISHTINË

10/01/2017



Avni DEHARI
Prishtinë

Ankesa Nr. 2016/252 Avni Dehari kundër Klan Kosova
Ref:1612/1355/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2016/252–Avni Dehari (Palë Ankuese) kundër Klan Kosova

Faktet

1. KPM, me datën 18 nëntor 2016, ka pranuar një ankesë nga z. Avni Dehari (Palë Ankuese) përmes të cilës pretendon se ofruesi i shërbimeve programore Klan Kosova, përkatësisht gazetari z. Baton Haxhiu në emisionin Zona e Debatit të transmetuar me datën 10 nëntor 2016, ka transmetuar pamje nga kamerat e sigurisë së Qendrës së Paraburgimit në Prizren, vend ky në të cilin humbi jetën i ndjeri Astrit Dehari.
2. Pala Ankuese pretendon se materialet janë transmetuar pa ndonjë autorizim përkatës dhe se këto materiale kanë qenë fyes dhe denigrues për familjen.
3. KPM, me qëllim të sqarimit të ankesës, me datën 21 nëntor 2016, përmes një Shkrese ka njoftuar Klan Kosovën lidhur me ankesën e familjes Dehari dhe ka kërkuar prej saj sqarim lidhur me kronikën e transmetuar.
4. KPM, me datën 23 nëntor 2016, ka pranuar një përgjigje nga Klan Kosova ndaj shkresës së datës 21 nëntor 2016, përmes së cilës sqaron se Klan Kosova si medium nuk e ka pasur fare të lehtë vendimin për të publikuar video-inçizimit, mirëpo ky vendim ka ardh si rezultat i asaj se publikimi i këtyre materiale ka qenë në interes të publiku duke pas parasysh gjendjen e krijuar pas rasti Dehari.
5. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore ka bërë monitorimin e emisionit Zona e Debatit ndaj së cilit është bërë ankesa dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 23 shtator 2016, KPM ka gjetur se Klan Kosova ka transmetuar kronikën në lidhje me rastine ndodhur në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, vend ky në të cilin humbi jetën i ndjeri Astrit Dehari.

Analiza Ligjore

6. Pretendimet e Palës Ankuese dhe të gjeturat e KPM-së, në lidhje me kroniken e transmetuar në Klan Kosova:

a. Pala ankuese pretendon se Klan Kosova ka bërë publikimin e materialeve për të ndikuar tek opinionimi publik për mënyrën e vdekjes së Astrit Deharit, veprim ky i cili bie në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

7. KPM, ka analizuar këtë pretendim të palës ankuese, duke marr për bazë përgjigjën e Klan Kosovës dhe të gjeturat nga monitorimi zyrtar i KPM-së, dhe ka vërejtur së kronika e transmetuar në Klan Kosova, me datën 11 nëntor 2016, kishte për qëllim informimin e publikut për një ngjarje e cila përbënte interes publik. KPM, gjithashtu gjen se kronika ka qenë e balancuar dhe se opinionet dhe mendimet e dhëna nga palët e përfshira në kontekst, nuk kanë pasur për qëllim vlerësimin ose konstatimin rreth mënyrës së vdekjes së Astrit Deharit, veprim ky i cili do të ishte kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ato nuk duhet të transmetojnë materiale për të cilin e din ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues”

b. Pala ankuese pretendon se Klan Kosova ka bërë publikimin e materialeve të cilat janë fyese dhe denigruese për familjen.

8. KPM, ka vlerësuar këtë pretendim ankimor të Palës Ankuese në raport me nenin 7, paragrafi 8, të Kodi të Etikës KKPM 2016/03 i cili përcakton se:

“Rrëfimet për tragjeditë personale duhet të paraqiten me kujdes dhe mirëkuptim nga ana e OSHM-ve”.

9. KPM, lidhur me këtë çështje, ka gjetur se kronika e transmetuar në Klan Kosovë, është trajtuar më kujdes të shtuar nga ana e moderatorit të emisionit “Zona e Debatit” për faktin së gjatë kronikës se transmetuar nuk janë identifikuar pamje të qarta të cilat në mënyrë direkte do të ishin përtej nevojës për të transmetuar një ngjarje me interes të gjer publik.
10. KPM, gjithashtu ka analizuar kronikën e transmetuar në Klan Kosovë edhe në raport me nenin 6, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 i cili përcakton se:

“OSHMT-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve më interes publik dhe çështjeve të kundërthënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, kundërshtimit politik apo ndonjë grup individi”.

11. KPM, bazuar në analizën e bërë transkriptit të emisionit Zona e Debatit të transmetuar në Klan Kosova dhe përgjigjes se ofruar nga Klan Kosova, ka gjetur se publikimi i video-incizimit kishte për qëllim informimin e publikut me qëllim të shmangies se konfuzioneve dhe paqartësive të krijuara si rezultat i ngjarjes se ndodhur në rastin Dehari. KPM, gjithashtu gjene se Klan Kosova ka siguruar një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve në lidhje me rastin, pa asnjë privilegj për ndonjë grup apo individ.

12. Prandaj, KPM, duke u bazuar në analizën dhe të gjitha faktet e lartpërmendura gjen se transmetimi i video-inçizimit në emisionin "Zona e Debatit" të transmetuar me datë 10 nëntor 2016, në Klan Kosova, ka qenë në interes të informimit të publikut për një ngjarje e cila ve në dukje sistemin e brishtë të organeve vitale të shtetit.
13. Ankesa e palës ankuese është trajtuar në raport me të gjitha dispozitat e Kodit të Etikes KKPM 2016/03.

Vendimi


14. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se, Klan Kosova, me kroniken e transmetuar me datën 10 nëntor 2016, në emisionin Zona e Debatit, nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.

E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



28.12.2016

datë